

KONTRATA SOCIALE FIER

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE SHTATOR 2020-SHTATOR 2021

Viti i II-të i monitorimit

PËRGATITUR NGA:
QENDRA "EPOKA E RE"



RAPORTI MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

TË KONTRATËS SOCIALE

BASHKIA FIER

POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

Shtator 2020 – Shtator 2021

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin të



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim



Gender Studies Development Center
Qendra e Studimeve të Zhvillimit



IVY.CJ
- vlera gjimnaziale -



IRSH
"Instituti i Rishikimit dhe Shpirtit"





qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

-  Qendra “Aleanca Gjinore per Zhvillim, Tiranë;
-  Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
-  Qendra Rinore Vlorës,
-  Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamez;
-  Epoka e Re, Fier;
-  Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
-  Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
-  Qendra Rinore për Progres, Kukës,
-  Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec.
-  "Hapa të Lehtë", Vau i Dejës;
-  "Tjetër Vizion", Elbasan;
-  "Gruaja në Zhvillim", Korçë.

Ky Raport është Përgatitur nga Epoka e Re në kuadër të projektit POP 2019 “Monitorimi i zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve.



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Tabela e Përmbajtjes

SHKURTIME	5
FALENDERIME.....	6
HYRJE.....	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	10
GJETJET	11
KONTRATAT SOCIALE BASHKIA FIER	12
KËSHILLI BASHKIAK FIER	14
MBLEDHJET E KËSHILLIT TË BASHKISË FIER	16
GJETJE NGA BASHKIA FIER	17
GJETJE NGA KOMUNITETI	24
ANALIZA E PRIORITETEVE	27
PRIORITET 1: TRANSPARENCA.....	27
PRIORITET 2 : INFRASTRUKTURA	29
PRIORITET 3: SHËRBIMET SOCIALE	30
PRIORITET 4: VËMENDJE NDAJ TË RINJVE	30
PRIORITET 5: VËMENDJE NDAJ FËMIJËVE	31
REKOMANDIME	32
ANEKSE	34

Shkurtime

BF	Bashkia Fier
NJA	Njësi Administrative
KB	Këshilli Bashkiak
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministratave
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
ZK	Zonë Kadastrale
PBA	Buxheti Afat - Mesëm
PRP	Plani Rugor për Pasaportën
PVMIM	Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve
POP	Përballja e Ofertave Politike
OSHC	Organizata e Shoqërisë Civile
COVID-19	Koronavirusi Sars – kovid
Kontrata Sociale ¹	Me prioritete të përzgjedhura nga komuniteti në vitin 2019

¹ <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-me-prioritetet-kryesore-fier/>



Falenderime

E bukur, por e vështirë është të ndërtosh një dokument mbi bazën e fakteve dhe përpjekjeve të ndërsjellta. E lehtë është në kushtet e ekzistencës së një vullneti të përbashkët për ta realizuar atë dhe e vështirë bëhet kur mungon ky vullnet. Kjo është një nga arsyet objektive që falenderimi i parë duhet të jetë për Bashkinë Fier dhe Këshillin e Bashkisë Fier për vullnetin, disponibilitetin e mbështetjen që i kanë dhënë projektit gjatë kësaj periudhe, si dhe motivimin dhënë të rinjve/grupit monitories në të gjitha mbledhjet e zhvilluara nga ky këshill. Sigurisht që pa mendimin dhe përkrahjen e qytetarëve rezultatet nuk do të ishin të njëjta. Falenderime të gjithë qytetarëve që pranuan të bëheshin pjesë e intervistave/fokus grupeve tona, të gjithë të rinjve të shkollave të mesme të qytetit që u bënë pjesë e fokus grupeve, mësuesve dhe banorëve të ndryshëm në zonat urbane e rurale të Bashkisë Fier.

Faleminderit të rinjve vullnetarë të qendrës Epoka e Re, të cilët kanë qenë mjaft aktiv gjatë kësaj kohe dhe kanë monitoruar me sukses të gjithë aktivitetin e Këshillit Bashkiak Fier, Bashkisë Fier, si dhe monitorimin e progresit të premtimeve që rrjedhin nga Kontrata Sociale POP - 2019.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED –National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleancë Gjinore për Zhvillim





Hyrje

Gjatë vitit 2019 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin "Përballja e Ofertave Politike - 2019 (POP 2019)" në 9 bashki të vendit, Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër. Përgjatë vitit 2019 u arrit që të nënshkruheshin disa Kontrata Sociale të hartuara bazuar në prioritetet e komunitetit midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura.

Gjatë vitit 2019, para dhe gjatë fushtës Elektorale ne jemi fokusuar tek sjellja së bashku e grupeve lokale të të rinjve në zonat urbane dhe rurale për të zgjedhur përparësitë e të rinjve dhe më pas prezantimit të përparësive të zgjedhura për kandidatët në zgjedhjet vendore. Hartimi i Kontratës Sociale bëri që të rinjtë të kenë një mjet për të mbajtur kandidatët e zgjedhur për Kryetar Bashkie dhe Këshillin e Bashkisë përgjegjës për adresim e tyre.

Forumet publike me të rinj dhe komunitetin kanë adresuar çështjet e shërbimeve publike; Qeverisja e mirë lokale; zhvillimi ekonomik lokal dhe dimensionin social. Kontakti i drejtpërdrejtë me të rinjtë në shkollat e mesme nga zonat rurale dhe urbane të përfshira në proces kontribuoi me propozime konkrete si prioritetet e të rinjve dhe komuniteteve të tyre.

Gjatë vitit 2020, Rrjeti POP monitoroi zbatimin e kontratave sociale në 9 bashki. Këto kontrata u zhvilluan bazuar në përparësitë e komunitetit në periudhën parazgjedhore 2019, dhe u nënshkruan nga kandidatët për kryetarë. Ndërkohë që Kontrata Sociale në vetvete rregullon marrëdhëniet në një shoqëri, midis njerëzve; midis njerëzve dhe qeverisë së tyre dhe institucioneve të tjera, ne po menaxhojmë një pjesë të saj. Si e tillë, kontrata sociale e nënshkruar midis kryetarëve të bashkive dhe organizatave partnere në POP përmban çështje të rëndësishme të cilat qytetarët kërkojnë t'i zgjidhin sa më shpejt që të jetë e mundur nga bashkia.

Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioritetëve të kontratës sociale për periudhën Shtator 2020 – Shtator 2021, referuar edhe rezultateve të monitorimit të vitit të kaluar (2020).

Pas fazës së parë të kësaj nisme që konsistonte në konsolidimin e saj me Qeverisjen vendore, njihjen me prioritetet e Kontratës Sociale, deklarimin publik të saj me aktorët kryesorë vendore, kjo periudhë përfshin procesin e monitorimit të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, të zbatimit të prioritetëve të kontratës sociale, të forcimit të marrëdhënieve midis qytetarëve, POP dhe aktorëve të tjerë në shoqëri. Pjesë e rëndësishme e kësaj faze të projektit është raportimi dhe veshja me përgjegjësi e drejtuesve në nivelin lokal për të përmbushur kontratën sociale të dakordësuar 2 vite më parë.



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim



CSDC
Community Development Center
"Citizen's Development Center"



IV.Y.C.I
"Young Youth Center"



IRSH
"Institute for Research and Studies"



lëvizja rinore
për demokraci



Center for
Youth Program



TIQS



TIQS




Gruaja e Zhvillimit
Koryb



NAPA VE CENTER

Pasojat e situatës së krijuar nga COVID-19, edhe pse në nivel më të ulët, u reflektuan edhe gjatë periudhës Shtator 2020 – Shtator 2021. Pothuajse të gjitha mbledhjet e këshillit bashkiak Fier, me disa përjashtime vijuan të zhvillohen online edhe gjatë kësaj periudhe. Epoka e Re edhe gjatë kësaj periudhe ka vijuar ecurinë e vitit të kaluar duke përshtatur aktivitetet e saj për të ndjekur reagimin e pushtetit qendror e lokal si dhe problemet e komunitetit në përshtatje me protokollet e sigurisë.

Metodologjia



Për realizimin e këtij raporti, qendra Epoka e Re, pjesë e rrjetit të POP, u bazua në informacione dhe fakte të grumbulluara në tre mënyra, nëpërmjet:

- ❖ Bashkisë
- ❖ Qytetarëve
- ❖ Monitorimit

Hapat e ndjekur

- ✓ Përpilimi i shkresës zyrtare drejtuar Bashkisë Fier ishte hapi i parë i nisjes së procesit të formalizimit të një pune një vjecare. Shkresa, “Kërkesë për informacion” u bazua në rezultatet e një viti më parë mbi nivelin e përmbushjeve të prioriteteve të kontratës sociale dhe u dërgua në emailin info@bashkiafier.gov.al.
- ✓ Takime të drejtëpërdrejta me përfaqësues të Bashkisë Fier për informacione specifike, kryesisht për çështjet e paadresuara ende.
- ✓ Paralel me këto takime u zhvilluan edhe fokus grupet me qytetarët dhe grupet e interesit që lidhen direkt ose indirect me përmbushjen/mospërmbushjen e prioriteteve të kontratës sociale.
- ✓ Monitorimit në vetvete u shtri në këto mënyra:
 - Monitorim i mbledhjeve të këshillit bashkiak (gjatë gjithë periudhës shtator 2020 – shtator 2021).
 - Monitorim i <http://bashkiafier.gov.al/>, faqja zyrtare e bashkisë Fier dhe FB- <https://www.facebook.com/bashkia.efierit/>.
 - Monitorim faktik për çdo prioritet (gjatë periudhës së grumbullimit të informacioneve dhe takimeve me qytetarët dhe grupet e interesit).
 - Monitorim i implementimit të buxhetit/buxhetit afatmesëm, PBA, etj.
 - Monitorim dhe analizim i mediave audio vizive dhe on line, sipas fushave specifike. Sjellja dhe qasja e tyre.

POP 2021 - KONTRATA SOCIALE, MJET PËR TË FORCUAR MARRËDHËNIET MES QYTETAREVE DHE PUSHTETARËVE

Gjatë periudhës Shtator 2020 – Shtator 2021 organizata, bazuar në objektivat e projektit, kishte si qëllim:

- Fuqizimin e ndikimit të zërit qytetar, OSHC-ve për të monitoruar dhe advokuar pranë bashkisë Fier për zbatimin e kornizës ligjore, si dhe përmbushjen e prioriteteve të kontratës sociale.
- Forcimin e rrjetit POP nëpërmjet bashkëpunimeve dhe komunikimeve të vazhdueshme për ta shtrirë impaktin edhe në bashki të tjera, jashtë territorit të veprimtarisë.
- Forcimin e marrëdhënieve midis qytetarëve, POP dhe aktorëve të tjerë në shoqëri,

realizuar kjo nëpërmjet kontakteve të shumta dhe prezencës së vazhdueshme në komunitet.

- Monitorimi, raportimi dhe nxitja e drejtuesve në nivelin lokal për të përmbushur kontratën sociale në Bashkinë Fier.

Aktorët dhe target grupet e përfshira në proces:

- ✚ Bashkia Fier dhe Këshilli Bashkiak Fier;
- ✚ Kryetari i Bashkisë Fier, Kryetari i Këshillit Bashkiak Fier.
- ✚ Media dhe Organizatat e Shoqërisë Civile si aleatë në këtë proces.
- ✚ Të rinjtë, gratë, qytetarët.

Kjo nismë mbështetet nga Olof Palme International Center, me fonde të Qeverisë Suedeze si dhe nga National Endowment for Democracy.

Përmbledhje Ekzekutive

Forcimi i marrëdhënieve mes qytetarëve, të rinjve dhe përfaqësuesve të qeverisjes në nivel vendor duke përdorur si mekanizëm bashkëpunimin me qëllim përmbushjen e kontratës sociale, ishte fokusi i punës së projektit POP gjatë periudhës shtator 2020 – shtator 2021 në Bashkinë Fier.

- ❖ Gjatë kësaj periudhe ka vijuar monitorimi i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, të cilat në pjesën më të madhe të tyre janë realizuar online.
- ❖ Ka vijuar gjithashtu monitorimi, evidentimi i zbatimit të prioriteteve të kontratës sociale, duke i sjellë ato vazhdimisht nën vëmendjen e vullnetit dhe punës së qeveritarëve vendorë.
- ❖ Është punuar fort për forcimin e marrëdhënieve ndërvepruese mes trinomit qytetarë – oshc – qeverisje vendore, duke mos u mjaftuar vetëm parimisht por edhe duke i vënë përballë angazhimeve e mosrealizimeve në formën e një përgjegjësie të dakordësuar 2 vite më parë.
- ❖ Pasojat e situatës së krijuar nga COVID-19, edhe pse në nivel më të ulët, u reflektuan edhe gjatë periudhës Shtator 2020 – Shtator 2021. Pothuajse të gjitha mbledhjet e këshillit bashkiak Fier, me disa përjashtime vijuan të zhvillohen online edhe gjatë kësaj periudhe.
- ❖ Epoka e Re edhe gjatë kësaj periudhe ka vijuar përshtatshmërinë e aktiviteteve të saj, të nxitur edhe nga faktorë të jashtëm, për të ndjekur reagimin e pushtetit qendror e lokal si dhe problemet e komunitetit në përshtatje me protokollet e sigurisë.

Gjetjet

- Gjatë periudhës shtator 2020 – shtator 2021, Këshilli Bashkiak Fier ka marrë 128 vendime, 80 prej të cilave kanë ndikim direkt ose indirekt në përmbushjen e pikave të kontratës sociale 2019.
- Përgjithësisht mbledhjet janë zhvilluar online. Duke filluar nga muaji shtator 2021 mbledhjet filluan të zhvillohen në auditor/sallën e mbledhjeve të KBF.
- Hartimi i një rregulloreje të procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje, e cila ka kaluar edhe miratimin e Këshillit Bashkiak, duke e bërë procesin edhe më të rëndësishëm me prezencën e detyrueshme të anëtarëve të KB-së.
- Bashkia përdor të gjitha mënyrat për të shpërndarë njoftimet me interes publik: online dhe shpallje në vende me akses të gjerë.
- Shpërndarja e informacionit bëhet nëpërmjet faqes zyrtare të bashkisë <http://bashkiafier.gov.al/>; FB- <https://www.facebook.com/bashkia.efierit/>.
- Kërkesë - ankesat e qytetarëve bëhen nëpërmjet: internetit në adresën zyrtare të bashkisë info@bashkiafier.gov.al; me shkresë nëpërmjet zyrën me një ndalesë (nëpërmjet kordinatorit të informimit); me postë/në kutinë postare (inbox) të FB-së së bashkisë.
- Rruga më e përdorshme nga qytetarët për dërgimin e një kërkesë -ankesë është online (e-mail/fb) dhe takime të drejtëpërdrejta me personat përgjegjës ose kryetarin e bashkisë.
- Mendimi qytetar për evidentimin dhe selektimin e prioritetëve priret të merret në disa mënyra: fokus grupeve të interesit, takimeve të drejtëpërdrejta me qytetarë të ndryshëm dhe komunikimit virtual.
- Të rinjtë kanë qenë pjesa më aktive e zbatimit të këtij projekti në Bashkinë Fier.
- Të rinjtë – pjesëmarrës permanent në mbledhjet e Këshillit Bashkiak Fier.
- Të rinjtë – aktiv në monitorimin dhe advokimin e përmbushjes së kontratës sociale si në qytet ashtu dhe në njësi administrative.
- Media ka rritur ndikimin e saj lidhur më nxitjen e transparencës direkt dhe indirekt. Gjatë periudhës shtator 2020 – shtator 2021, mbi 80% të kërkesave për informacion në Bashkinë Fier janë depozituar pikërisht nga përfaqësuesit e medias jo vetëm lokale.
- Gjatë periudhës shtator 2020 – shtator 2021 janë finalizuar terrenet sportive pranë ETC, të cilat do të shërbejnë për të gjitha aktivitetet sportive të ngrupmoshave të ndryshme.
- Gjatë periudhës shtator 2020 – shtator 2021 është ndërhyrë në 38 godina, respektivisht: 23 shkolla; 11kopshte; 3 çerdhe; 1 konvikt.
- Gjatë periudhës shtator 2020 – shtator 2021, buxheti i shpenzuar nga bashkia Fier për rikonstrukcionin e godinave arsimore (shkolla, kopshte, çerdhe, konvikte) në total shkon në vlerën **44 952 215.428 lek**.
- Investimet me sipërmarrje në shkolla shkojnë në vlerën **41,341,000 lek**.

- Bashkia Fier ka gati projektet për rikonstruksionin e tre shkollave; tre terreneve sportive; ndërtimin e një shkolle të re në lagjen “Sheq i Madh”; ndërtimin e një çerdheje të re;
- Bashkia Fier tashmë prej vitesh ka gati projektin për ngritjen e një qendre pritëse psiko – sociale jo vetëm për gratë e dhunuara por dhe për fëmijët, si edhe alternativat për vendin e ngritjes së kësaj qendre.
- Bashkia Fier është e gatshme të vërë në dispozicion godinën dhe stafin funksional për mbarëvajtjen e saj
- Bashkia e Fierit nuk ka një zyrë/drejtori të dedikuar për Rininë. Funksionet e saj dhe realizimin e politikave të Bashkisë Fier për të rinjtë i kryen Qendra e Aktiviteteve Kulturore (QAK), ku realizohen të gjithë aktivitetet për të rinjtë dhe fëmijët.
- QAK funksionon në disa sektorë (valle, letërsi, arte pamore, sporte), që merren me organizimin e aktiviteteve (pjesë e aktiviteteve të qendrës dhe pjesë e kalendarit të aktiviteteve nga Drejtorisë së Artit dhe Kulturës (DAK).

Kontratat Sociale

Nisma e rrjetit POP synon të rrisë debatin publik dhe informacionin tek qytetarët mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për kryetarë bashkie, si dhe orientimin e këtyre platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Për të arritur këtë qëllim është hartuar Kontrata Sociale për të gjitha bashkitë, ku organizatat e rrjetit operojnë, e cila është firmosur nga Kryetari i Bashkisë. Kontrata Sociale është një dokument i hartuar me prioritetet e qytetarëve nga takime, fokus grupe dhe forume të organizuara gjatë periudhës parazgjedhore 2019. Prioritetet e komunitetit bazohen në katër shtylla kryesore:

- Shërbimet Publike
- Demokracia Vendore dhe Mirëqeverisja
- Zhvillimi Ekonomik Vendor
- DimENSIONI Social në Nivel Vendor

Kontratata Sociale nuk janë thjesht një premtim i shkruar, por një angazhim për kryetarët e zgjedhur për të përmbushur këto prioritete brenda katër vjeçarit të mandatit të tyre.

Kontrata sociale e Bashkisë Fier u formalizua më 17 tetor 2019¹, me dakortësimin/firmosjen e saj nga: Kryetari i Bashkisë Fier Z. Armando Subashi, Kryetari i Këshillit Bashkiak Fier Z. Vangjel Ndreko dhe Drejtoresha Ekzekutive e Qendrës Epoka e Re Fier Znj. Nevila Jahaj.

¹ <https://popnetwork.al/forumi-publik-pop-2019-fier/>

Nëpërmjet kësaj kontrate Bashkia dhe Këshilli Bashkiak angazhohen në realizimin e disa çështjeve që për komunitetin dhe kryesisht për të rinjtë janë prioritare. Kjo kontratë u firmos gjatë një Forumi Publik me pjesëmarrjen e të rinjve, shoqërisë civile, grupeve të interesit, qytetarëve e Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Fier.

Puna për përgatitjen e saj nisi muaj më parë. Përpara përpilimit të kësaj kontrate sociale u arrit grumbullimi i mendimit dhe prioriteteve të qytetarëve/të rinjve. U realizuan disa fokus grupe dhe u studiua e gjithë situata në territorin e Bashkisë Fier, shpërndarë në problematika e shërbime reale, marrëdhëniet e ndërveprimet komunitet/të rinj, qeverisje vendore etj.

Informacioni dhe rezultatet e grumbulluara nga këto zhvillime, u ndanë dhe selektuan në bazë prioritetesh nga të cilat u zgjodhën po nga të rinjtë nëpërmjet procesit fokus grup, ato më të rëndësishme dhe emergjente të cilat ndikojnë në cilësinë e jetës së tyre/komunitetit.

Prioritetet e përzgjedhura nga të rinjtë/komuniteti i Fierit, janë të shtrira në 5 shtylla kryesore, si më poshtë vijon:

1. Transparenca

Transparenca në menaxhinin e Njesisë së qeverisjes vendore, duke nisur nga njoftimet publike. Ato duhet të jenë më të shpeshta, të shtrira në kohë dhe publike; Akses të komunitetit dhe të të rinjve në dëgjuesat publike e në mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

2. Infrastruktura

Ndërtimi i sa më shumë terreneve sportive në qytet dhe Njësi Administrative, si dhe vënia në funksion e shkollave si qendra komunitare, kryesisht në zonat rurale.

3. Shërbimet sociale

Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për Gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë.

4. Vëmendje ndaj të rinjve

Buxhet specifik për të rinjtë dhe ngritja e një strukture (Drejtorie) të vecantë në Bashki që të koordinojë marrëdhënien dhe ndërveprimin me të rinjtë.

5. Vëmendje ndaj fëmijëve

Kthimi në identitet i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, duke rikthyer gjithashtu edhe grupet e kurset e fëmijëve, të cilët sot janë të papërfaqësuar.



Situata e prioriteteve -2020

Prioritet 1: Transparenca në menaxhinin e Njesisë së qeverisjes vendore, duke



nisur nga njoftimet publike. Ato duhet të jenë më të shpeshta, të shtrira në kohë dhe publike; Akses të komunitetit dhe të të rinjve në dëgjuesat publike e në mbledhjet e Këshillit Bashkiak. **(Adresuar Pjesërisht)**

Prioritet 2: Ndërtimi i sa më shumë terreneve sportive në qytet dhe Njësi Administrative, si dhe vënia në funksion e shkollave si qendra komunitare, kryesisht në zonat rurale. **(Adresuar Pjesërisht)**

Prioritet 3: Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për Gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë. **(Nuk është adresuar)**

Prioritet 4: Buxhet specifik për të rinjtë dhe ngritja e një strukture (Drejtorie) të vecantë në Bashki që të koordinojë marrëdhënien dhe ndërveprimin me të rinjtë. **(Adresuar Pjesërisht)**

Prioritet 5: Kthimi në identitet i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, duke rikthyer gjithashtu edhe grupet e kurset e fëmijëve, të cilët sot janë të papërfqësuar. **(Nuk është adresuar)**


Këshilli Bashkiak Fier

Këshilli Bashkiak Fier deri në vitin 2019 kishte në përbërje të tij 41 anëtarë. Rritja e popullsisë në vitin 2018 në Bashkinë Fier, duke kaluar kufirin e 200 000 banorëve e çoi numrin e anëtarëve të Këshillit (korrik 2019) në 51. Këshilli i ri i Bashkisë Fier është konstituuar më 29 korrik 2019 ka në përbërje të tij 51 anëtarë. Mbështetur në pikën a) të nenit 54 të Ligjit nr. 139/2015 datët 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore, si dhe në Rregulloren e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Fier, miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 63 datë 04.09.2007, kapitulli IX neni 35, Këshilli i Bashkisë Fier në mbledhjen e datës 07.10.2019 vendosi krijimin e komisioneve të përhershme.



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim





Komisionet e përhershme:


- Komisioni I Ekonomisë, Financës dhe Privatizimeve
- Komisioni Juridik dhe I çështjeve Institucionale
- Komisioni për Punët Publike dhe Emergjencat
- Komisioni I Çështjeve Sociale
- Komisioni për Çështjet e Zhvillimit Urban, Planifikimit të Territorit, Mjedisit dhe Shëndetit Publik.
- Komisioni I Arsimit, Kulturës, Sportit dhe i Marrëdhënieve me jashtë.
- Komisioni I Auditit.
- Komisioni I Votimit
- Komisioni për Mbikqyrjen, Kontrollin dhe Nënshkrimin e Proces – Verbaleve të Mbledhjes.
- Komisioni për Zhvillimet Bujqësore, Blegtorile dhe të Agrobiznesit.
- Komisioni për Barazinë Gjinore
- Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave për Shpalljen ose Njohjen e Statusit të "Dëshmorëve të Atdheut".

Mbledhjet e Këshillit të Bashkisë Fier

Një nga elementet kryesore të POP është monitorimi i mbledhjeve dhe vendimeve që dalin nga Këshilli i Bashkisë Fier.

Gjatë periudhës shtator 2020 – shtator 2021, Këshilli Bashkiak Fier ka marrë 128 vendime, 75 prej të cilave kanë ndikim direkt ose indirekt në përmbushjen e pikave të kontratës sociale 2019.

Përgjithësisht mbledhjet janë zhvilluar online, por duke filluar nga muaji shtator mbledhjet filluan të zhvillohen në auditor/sallën e mbledhjeve të KBF.




Ajo që vihet re gjatë vendimeve të marra nga KBF, tipologjia e tyre ka qenë përgjithësisht me karakter social/ekonomik, më pas vijon profile i zhvillimit infrastrukturor të qytetit e në disa raste vendime me karakter të ndryshëm: arsim, sport, kulturë etj.

Nga monitorimi i vendimeve të KBF, orientimi i ekzekutivit/KB, bazuar në kërkesat e qytetarëve, projekteve prioritare, ndërhyrjeve të nevojshme në kohë dhe hapësirë kanë qenë të pritura në përshkallëzim nga lart poshtë në këtë mënyrë:

- Mbështetje sociale, fokusuar në mbështetjet financiare si: ndihma të menjëhershme në rast sëmundjeje, ndihme për fëmijë jetim, përfshirje në shtëpinë e të moshuarve, etj. Numërohen 22 vendime të tilla.
- Mbrojtje civile që ka qenë e fokusuar në mbështetjen civile në rast tërmeti, zjarri etj. (18 vendime)
- Ndihmë ekonomike që bazohet më tepër në një procedurë ligjore dhe detyrim institucional. (15 vendime)
- Vendime që lidhen me problematika dhe zgjidhje që kanë patur nevojë për ndërhyrje në kohë e hapësirë. (11 vendime).
- Infrastrukturë e shërbime të ndryshme. (10 vendime).
- Vendime të tjera të ndryshme që lidhen me problematika të ndryshme, vendime për

procedura pronësie, kërkesa nga grupe interesi ose qytetarë etj. (52 vendime)

Gjetje nga Bashkia Fier



Informacionet nga Bashkia Fier janë marrë nëpërmjet një shkrese zyrtare dërguar në emër të projektit POP dhe nëpërmjet takimeve të drejtëpërdrejta me secilën drejtori respektive që lidhet me progresin e pikave të kontratës sociale.

1. Transparenca

Transparencë në menaxhinin e Njesisë së qeverisjes vendore, duke nisur nga njoftimet publike. Ato duhet të jenë më të shpeshta, të shtrira në kohë dhe publike; Akses të komunitetit dhe të të rinjve në dëgjesat publike e në mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

Edhe gjatë periudhës shtator 2020 – shtator 2021, Bashkia Fier ka vijuar përpjekjet për të rritur transparencën dhe interesin qytetar.

- Bashkia përdor të gjitha mënyrat për të shpërndarë njoftimet me interes publik: online dhe shpallje në vende me akses të gjerë.
- Shpërndarja e informacionit bëhet nëpërmjet faqes zyrtare të bashkisë

<http://bashkiafier.gov.al/> ; FB- <https://ëëë.facebook.com/bashkia.efierit/> .

- Kërkesë - ankesat e qytetarëve bëhen në rrugë të ndryshme: nëpërmjet internetit në adresën zyrtare të bashkisë info@bashkiafier.gov.al, me shkresë nëpërmjet zyrën me një ndalesë (nëpërmjet kordinatorit të informimit), me postë, ose në kutinë postare (inbox) të FB të bashkisë.
- Përsa i përket ankesave, në cdo godinë të njësive administrative është vendosur një kuti për hedhjen e ankesave të qytetarëve. Këto ankesa depozitohen në bashki dhe vlerësohen më pas sipas rastit.
- Rruga më e përdorshme nga qytetarët për dërgimin e një kërkesë -ankesë është online (e-mail/fb) dhe takime të drejtëpërdrejta me personat përgjegjës ose kryetarin e bashkisë.
- Pavarësisht se publikimi online i njoftimeve është më i shpejtë në shpërndarjen e informacionit, shpallja e tyre në vendet me akses të gjerë mbetet një formë e parapëlqyer nga qytetarët.
- Procesi i buxhetimit me pjesëmarrje është një nga format që qytetarët vihen përballë përfaqësuesve të qeverisjes vendore dhe diskutojnë hapur mbi problematikat shqetësuese.
- Publikimi i njoftimeve, së bashku me rendin e ditës mbi mbledhjet e këshillit bashkiak është një tjetër aspekt që nxit pjesëmarrjen dhe transparencën e vendimmarrjes.
- Prania e të rinjve në mbledhjet e këshillit bashkiak tashmë ka krijuar një traditë, duke krijuar më shumë hapësirë për përgjegjshmëri, llogaridhënie dhe angazhim si nga ekzekutivi ashtu dhe nga përfaqësuesit e qytetarëve (këshilltarët).
- Media ka intensifikuar ndikimin e saj në nxitjen e transparencës institucionale, në mënyrë direkte dhe indirekte.
- Gjatë periudhës shtator 2020 – shtator 2021, mbi 80% të kërkesave për informacion në Bashkinë Fier janë depozituar pikërisht nga përfaqësuesit e medias, jo vetëm lokale.


2. Infrastruktura

Ndërtimi i sa më shumë terreneve sportive në qytet dhe Njësi Administrative, si dhe vënia në funksion e shkollave si qendra komunitare, kryesisht në zonat rurale.

- Bashkia Fier gjatë periudhës Shtator 2020 – shtator 2021 ka ndërhyrë pothuajse në të

gjitha institucionet arsimore. Diku me rikonstrukcion të plotë, diku restaurime dhe në të gjitha sistemim e dezinfektim. Kemi ndërtuar një shkollë të re e cila u shemb për shkak se ishte tejet e amortizuar, shkolla e Darëzezës së Re. kemi ndërtuar dhe përshtatur (rehabilituar) disa terrene sportive në shkolla dhe hapsira publike në qytet dhe Nj.A.

- Në të gjitha shkollat që kanë pësuar rikonstrukcion të plotë janë krijuar mundësitë e funksionimit të tyre si qendra komunitare, por situata e pazakontë e krijuar nga pandemia e ka lënë në mes këtë proces.




Gjatë periudhës shtator 2020 – shtator 2021 janë finalizuar terrenet sportive pranë ETC, të cilat do të shërbejnë për të gjitha aktivitetet sportive të ngrupmoshave të ndryshme. Këto terrene janë Brenda godinave dhe infrastruktura e ngritur përt to është e parametrave bashkëkohore. Përveç ambienteve të brendshme I është kushtuar rëndësi dhe infrastrukturës së jashtme. Për një akses më të mirë është investuar në infrastrukturën rrugore dhe hapësirave të parkimit, për një aksesueshmëri sa më të plotë.

Bashkia Fier ka gati projekte:

- Rikonstrukcionin e tre shkollave;
- Tre terreneve sportive;
- Ndërtimin e një shkolle të re në lagjen “Sheq i Mash”;
- Ndërtimin e një çerdheje të re;

Nr	EMERTIMI	VLERA
1	Kopshti ne lagjen "15 Tetori" banesa private	280285.12
2	Kopshti nr.6	9320.8
3	Shkolla Mark Dashi	400
4	Shkolla ne fshatin Petove	16384
5	Shkolla Jani Bocova ne Afrim	1400

6	Cerdhja nr.1	13958.5
7	Cerdhja nr.2	3575
8	Shkolla Llazar Dashi	189850
9	Shkolla ne fshatin Pojan	9000
10	Kopshti ne fshatin Portez	236110.82
11	Kopshti nr.3	80355
12	Shkolla Naim Frasheri	5959.49
13	Konvikti ne fshatin Ferme Clirim	31490.08
14	Shkolla Naum Kacaku ne Portez	219790.6
15	Gjimnazi Mustafa Hoxha ne Cakran	5320
16	Shkolla Levizja demokratike ne Povelc	15942
17	Kopshti ne lagjen 1 Maji banese private	243876.68
18	Shkolla 9 vjecare ne Patos Fshat	192070
19	Shkolla 9 vjecare ne Cakran	23520
20	Kopshti ne Peshtan te Madh	17350
21	Shkolla Mehmet Salo Shanaj ne Peshtan te Madh	2960
22	Shkolla ne Peshtan Bregas Avdi Metaj	205391
23	Shkolla ne fshatin Shtyllas	164700
24	Shkolla ne fshatin Ferras	237900
25	Shkolla ne Kafaraj	459105.94
26	Kopshti ne fshatin Shtyllas	137995
27	Gjimnazi me Kohe te Pjeshme ne Fier	64424.16
28	Shkolla SHMKSH	2100
29	Gjimnazi Janaq Kilica ne Fier	255
30	Kopshti nr.4	9250
31	Kopshti nr.5	103653
32	Shkolla Dino Ismaili ne Levan	20276
33	Cerdhja nr.3	2000
34	Kopshti nr.7	1500
35	Kopshti nr.8	1878
SHUMA		3009346.19
TVSH		601869.238
TOTALI		3611215.428



3. Shërbimet sociale

Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për Gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë rurale.

Bashkia Fier tashmë prej vitesh ka gati projektin për ngritjen e një qendre pritëse psiko – sociale jo vetëm për gratë e dhunuara por dhe për fëmijët. Ky projekt është lobuar dhe vijon të llobohet vazhdimisht me Ministrinë, organizata të ndryshme edhe ndërkombëtare, por nuk ka mundur të gjejë mbështetje financiare. Bashkia Fier përveç projektit ka gati dhe alternativat për vendin e ngritjes së kësaj qendre. Gjithashtu, Bashkia Fier është e gatshme të vërë në dispozicion godinën dhe stafin funksional për mbarëvajtjen e saj, por mesa duket prioritetet e Bashkisë Fier nuk përputhen me prioritetet e organizatave apo Ministrinë, të cilat kanë qenë më shumë të fokusuara në ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve të ngritura më parë, apo mbështetjen e grupeve specifike si: komuniteti Rom/Egjiptian etj.

4. Vëmendje ndaj të rinjve


Buxhet specifik për të rinjtë dhe ngritja e një strukture (Drejtorie) të vecantë në Bashki që të koordinojë marrëdhënien dhe ndërveprimin me të rinjtë.

- ❖ Aktualisht Bashkia e Fierit nuk ka një zyrë/drejtori të dedikuar për Rininë.
- ❖ Funkcionet e saj dhe realizimin e politikave të Bashkisë Fier për të rinjtë i kryen Qendra e Aktiviteteve Kulturore (QAK), ku realizohen të gjithë aktivitetet për të rinjtë dhe fëmijët.
- ❖ Në Buxhetin e Bashkisë Fier nuk ka zë të dedikuar për të Rinjtë, por nga buxheti i bashkisë janë financuar të gjitha aktivitetet për të rinjtë/fëmijët të cilat janë organizuar nga bashkia dhe organizata për të rinjtë.
- ❖ Ka bashkëpunime të vazhdueshme me organizatat edhe me fokus rininë, ose aktivitetet rinore dhe veçanërisht me qendrën Epoka e Re.

5. Vëmendje ndaj fëmijëve

Kthimi në identitetin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve, duke rikthyer gjithashtu edhe grupet e kurset e fëmijëve, të cilët sot janë të papërfaqësuar.

QAK funksionon në disa sektorë (valle, letërsi, arte pamore, sporte), që merren me organizimin e aktiviteteve (pjesë e aktiviteteve të qendrës dhe pjesë e kalendarit të aktiviteteve nga Drejtorisë së Artit dhe Kulturës (DAK).



- Në bashkëpunim me shkollat 9 – vjeçare e të mesme, kjo qendër organizon një kalendar vjetor aktivitetesh, të cilat synojnë përfshirjen masive të nxënësve, si dhe evidentimin e vlerave më të mira të fëmijëve dhe sidomos të të rinjve të shkollave të mesme.
- Marrin pjesë në aktivitete të ndryshme që zhvillon Bashkia dhe institucione të tjera vendore.

Gjatë vitit 2021 (janar - tetor) edhe pse në pandemi dhe shkollat kanë qenë të mbyllura deri në shtator 2021, janë organizuar këto aktivitete:

***Ndonëse situatë pandemike,
me pjesëmarrje të
kufizuar, gjatë kësaj
periudhe, në aktivitetet
kulturore, letrare e sportive,
janë angazhuar mesatarisht
1 (një) mijë nxënës të
moshave të ndryshme.***

- “Kërcim dashurie” – të rinjtë e shkollave të mesme (Janar – Shkurt 2021)
 - Festa e 7 marsit dhe 8 marsit – aktivitet me recitime, këngë, kërcime nga nxënës të shkollave fillore, 9 vjeçare/ të mesme dhe të ftuar personalitete veteranë të arsimit fierak (janar – mars 2021).
- “The best talents 2021” – konkurs (poezi/interpretim/prezantim; këngë/solo/në grup; valle/pop,balet, kërcim modern), me pjesëmarrjen e të rinjve të shkollave të mesme nga Fieri, Patosi, Roskoveci, Ballshi, Lushnja, Divjaka. (Shkurt – Korrik 2021).
- Aktivitet në nder të shkrimtarit Ismail Kadare – (Maj 2021).
- Banda Frymore – koncert (Qershor – Korrik 2021).
- Festivali Foklorik Rumani – minikoncert i QAK-së (korrik 2021).
- Festivali Ndërkombëtar Foklorik Vaslui Rumani – minikoncert i QAK-së (Gusht 2021).
- Festivali Tipologjik i Elbasanit – minikoncert i QAK-së.
- Festivali Folklorik Kombëtar i Valles Lushnje – minikoncert i QAK-së (Gusht 2021).
- Festivali Ndërkombëtar Foklorik Beograd – minikoncert i QAK-së (Gusht 2021).
- Koncert i Armando Kllogeri – (Gusht 2021).
- Festivali Ndërkombëtar Foklorik Turqi – minikoncert i QAK-së (Shtator 2021).
- Festivali Folklorik Kombëtar i Valles Berat – minikoncert i QAK-së (Shtator 2021)
- Aktivitet në nder të heroines Liri Gero – (Shtator 2021).
- Koncert me rastin e hapjes së shkollave – koncert me këngë, valle, recitime.
- Koncert për Romët – koncert me këngë, valle, recitime.
- “Tetori i librit” – aktivitete me shkollat 9 vjeçare e të mesme (Tetor 2021).
- “Krosi i vjeshtës” – me shkollat 9 vjeçare e të mesme (Tetor 2021).
- Festa e 15 tetorit – koncert me këngë, valle, recitime e prezantime të ndryshme

(Tetor 2021).

- Festa e Krijimit të brigadës XI sumuese (Të njohësh historinë dhe traditën) – koncert me këngë dhe recitime (Tetor 2021).

Gjetje nga komuniteti

Ndryshe nga një vit më parë, kontakti me komunitetin ka qenë i vazhdueshëm. Krahas monitorimit të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Fier, ka vijuar edhe monitorimi në terren dhe kontaktet me komunitetin/grupet e interesit kryesisht mbi çështjet e kontratës sociale 2019. Pavarësisht përgjigjeve zyrtare që Epoka e Re ka marrë nga takimet permanente me përfaqësues të Bashkisë Fier gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit, drejtuesit e drejtorive me ndikim direkt/indirect lidhur me nivelin e përmbushjes së prioriteteve të kontratës sociale nuk është ndalur për asnjë moment kontakti me qytetarët dhe terrenin. Gjatë periudhës shtator – tetor 2021, qendra Epoka e Re zhvilloi disa fokus grupe me qëllim trajtimin e prioriteteve të kontratës sociale. Target grupet e synuara ishin: gratë, të rinjtë, komunitet të zonave rurale, komuniteti Seman (me përfshirje të gjerë gra/të rinj) përfshirë grupet e marginalizuara, komuniteti i bashkisë qendër (qytet), të rinjtë e zonave rurale.

Në këto takime u diskutuan në detaje problematikat, ecuria, puna e bërë ose e jo për përmbushjen e të gjitha prioriteteve të kontratës sociale, por dhe performanca e bashkisë/shërbimeve në përgjithësi.

Për shkak të situatës pandemike, numri i pjesëmarrësve ishte i kufizuar, - 15 pjesëmarrës në çdo takim. Takimet u zhvilluan nën respektimin e masave mbrojtëse anti-covid (maska, dezinfektues, distancë sociale).

Transparenca

- Perceptimi qytetar në lidhje me transparencën e Bashkisë Fier është i luhatshëm. Herë ka nxitje të një përmirësimi të këtij elementi dhe herë ka një ulje drastike të tij. Përgjithësisht komuniteti është i njohur me mënyrën e njoftimeve, kërkesave, ankesave drejtuar Bashkisë, por pjesa më e madhe e tyre nuk kanë patur kontakt të drejtëpërdrejtë me institucionin. Perceptimi se mungon transparenca në këtë institucion e kanë të shprehur nga të tjerët dhe ky fakt i ka stepur për tu përballur vetë në rast problematike qoftë dhe personale.
- Bashkia Fier publikon sistematikisht njoftimet dhe zhvillimet e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Përveç faqes zyrtare të Bashkisë, këtë vit edhe Këshilli i Bashkisë ka hapur një faqe në rrjet social për të pasqyruar në kohë reale dhe shpërndarje më të gjerë të informacionit duke qenë se FB është një mjet më popullor për komunitetin pa kufizim moshe.
- Mungesë të këtij informacioni dhe gjithcka që lidhet me bashkinë ka komuniteti në zonat rurale. Faqen zyrtare të bashkisë Fier pothuajse asnjë prej tyre nuk e kishte hapur

ndonjëherë. Ajo që ishte parë në një numër të ulët të tyre ishte vetëm llogaria në rrjet social (FB).

- Nëse për komunitetin e zonës rurale elementi transparencë përkufizohej me kontaktin direkt me administratirin e NJA, nga ana e komunitetit të zonës urbane ky element lë shumë për të dëshiruar. Ata janë shprehur se Bashkia vazhdon të ketë mungesë të theksuar transparence. Takimet me kryetarin e Bashkisë janë bërë më të ralla, gati të pamundura.
- Vazhdon të jetë primare kontakti me drejtuesit e institucioneve duke u munduar ti zgjidhin problematikat pa procedura. Ata janë shprehur se ka procedura burokratike, gati gati të pamundura qoftë për një problematikë fare të vogël sic mund të jetë një riparim defekti Brenda shtëpisë. (Kjo është klasifikuar si një thellim hendeku mes qytetarëve dhe qeverisjes vendore apo qendrore qoftë ajo.
- Ajo që vazhdon të jetë themelorë mbetet fakti që nga ana e Bashkisë Fier kërkohet një angazhim më i madh në mënyrën e publikimit dhe përcjelljes së njoftimeve/informacioneve, pasi shpesh herë komuniteti nuk njihet me to nëse nuk interesohet vetë herë pas here. Për këtë duhen gjetur mekanizma për ta imponuar shpërndarjen e informacionit edhe tek ajo pjesë e komunitetit që nuk është aktive.
- Përsa i përket mbledhjeve të KB-së, nga ana e komunitetit ka një indiferencë të theksuar. Shumë pak prej tyre kishin për të dhe njoftimet e mbledhjeve për shkak se u ishte imponuar informacioni nga rrjetet sociale. Përvec disa të rinjve aktivistë dhe 3 personave kishin patur cështje personale që duheshin trajtuar, asnjë tjetër nuk kishte qenë në mbledhje të KB-së. Pjesa më e madhe e të rinjve, të organizuar nga qendra Epoka e Re, kanë frekuentuar vazhdimisht mbledhjet e këshillit, takimet publike, dëgjuesat etj.

Infrastruktura

- Edhe pse një nga prioritetet e bashkisë Fier ka qenë përmirësimi i godinave të shkollave, terreneve sportive dhe ambienteve shlodhëse, situatë e tyre vazhdon të jetë një problem që nuk ka marrë zgjidhje. Ka ndërhyrje të vazhdueshme në godinat e shkollave, kopshteve, cerdheve por ato janë të pamjaftueshme për të arritur standardin e nevojshëm. Ka një ndryshim të madh vit pas viti në këto godina, por është një problematikë që vijon të jetë present kryesisht në zonat rurale.
- Problematika e kushteve të godinave të shkollave është present edhe në zonën urbane ku prindër janë në pritje të zgjidhjes që do t'japë bashkia këtë vit për shkollën Liri Gero dhe shkollën e Sheqit.
- Përsa i përket terreneve sportive, këtë vit nga ana e Bashkisë Fier nuk është investuar në ndonjë terren sportiv në shkolla apo jashtë tyre, por është investuar në veshjen me elementët e nevojshëm (ndriçim, mobilim, shtrim tapeti bari etj) për terrenet sportive pranë ETC që do të shërbejnë për qytetarët dhe aktivitete të ndryshme kulturore,

edukative. Këto ambiente do të shërbejnë edhe në formën e një pallati sporti me akses të gjerë sipas informacioneve që shpërndara nga vet bashkia nga rrjetet sociale dhe media lokale.

- Përsa i përket funksionimit të shkollave si qendra komunitare ende nuk ka përparim. Situata pandemike, rreziku i dëmtimit të shkollave të rikonstruara dhe mungesa e stafit mbështetës për periudhën post shkollore janë pengesat që kanë çuar në këtë mosrealizim.
- Disa prej shkollave që përpara pandemisë shërbenin si qendra komunitare, për shkak të ndikimit të komunitetit të prindërve për mbrojtje të ambjenteve, e më pas pandemisë, mungesës së mbikqyrjes jashtëshkollore ka bërë që të mbyllen e të mos funksionojnë më si të tilla edhe sot.
- Është ringritur shqetësimi i komunitetit të fshatit Seman për rifunksionimin e qendrës komunitare Seman. Ata kanë deklaruar se kanë gati një petition dhe do e paraqesin atë pranë Bashkisë Fier me asistencën dhe mbështetjen e qendrës Epoka e Re, duke kërkuar ndërhyrjen institucionale. Ata janë shprehur gjithashtu se godina aty ekziston. Kërkon vetëm disa ndërhyrje të pjesshme infrastrukturore dhe ofrimin e disa shërbimeve.

Shërbimet sociale

(Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë).

Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë është një nevojë e shtuar, e cila çdo ditë e më shumë fuqizon ndikimin si prioritet. Ky fakt doli qartë edhe këtë vit nga fokus grupet dhe për më tepër duket se është një çështje që kërkon sa më shpejt adresim, për vet shtimin e shqetësimit të këtij fenomeni në komunitet. Rastet e rritura të rasteve të shfaqura të dhunës dhe problemet psiko- sociale në dukje të shtuara kanë rritur nevojën për ngritjen e kësaj qendre. Nga fokus grupet nuk pati ndonjë informacion në lidhje me përpjekjet e Bashkisë Fier. Ky mbetet ende një prioritet i paadresuar. Nga fokus grupet u kërkuar që qendra “Epoka e re” të bashkëpunojë me institucionet lokale në cilësinë e koordinatorit, për të nxitur ofrimin e programeve mbështetëse për gratë e vajzat viktime të dhunës me finalizim punësimin. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të sigurojnë pavarësinë ekonomike dhe luftojnë këtë problematikë të madhe shoqërore.

Vëmendje ndaj të rinjve

- Shumë pak prej tyre kishin informacion mbi ligjin e ri për rininë dhe mbështetjen/hapësirat që u ka dhënë ai të rinjve. Të gjithë ishin në një zë për një buxhet të dedikuar vetëm për të rinjtë.
- Askush prej tyre nuk kishte dijeni nëse bashkia Fier kishte një buxhet të dedikuar për të

rinjtë apo një zyrë/person kontakti për koordinimin e aktivitetete dhe të rinjve.

- Të gjithë ishin dakord për një buxhet për të rinjtë dhe për aktivitetet e tyre duke e parë këtë jo vetëm si mundësi fuqizimi dhe besimi për të rinjtë, por edhe si angazhim duke l larguar nga jeta parasitare/sedentare (lokale). Kjo do u japë mundësi të gjenerojnë aktivitete të reja dhe ndërmarrin nisma në shërbim të fuqizimit të tyre dhe ndikimit të komunitetit në vendimmarrje.
- Struktura e re e Këshillit Vendor Rinor, edhe pse e panjohur për shumicën e të pranishmëve në fokus grup shihet si mënyra më e mirë për të depërtuar në vendimmarrjen locale dhe për të nxitur transparencën, përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe qeverisjen e mirë.

Vëmendje ndaj fëmijëve

- Kthimi në identitet i Qendrës Kulturore të Fëmijëve për pjesëmarrësit ishte një rrugë tashmë e nisur.
- QAK ka ndryshuar muajt e fundit pas shumë kohë shkëputjeje nga pandemia.
- Kanë nisur të zhvillohen shumë aktivitete dhe rrethe (kurse).
- Ka rritur frekuentim edhe për shkollat e mesme.
- Rikthimi i kurseve/rretheve ishte një nevojë immediate dhe ndryshimi ka nisur.

Analiza e prioriteteve

Prioritet 1: Transparenca

- Nga monitorimet e bëra gjatë periudhës shtator 2020 – shtator 2021 është e dukshme përpjekja e Bashkisë Fier për të rritur transparencën. Njoftimet e mbledhjeve të këshillit kanë rritur numrin e kanaleve të publikimit. Ato publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë Fier www.bashkiafier.gov.al në fashën Këshilli I Bashkisë/ njoftime; në FB e Këshillit; FB e bashkisë.
- Këshilli I bashkisë Fier gjatë kësaj periudhe ka ndërmarrë vet organizimin dhe zhvillimin e një konsultimi publik në zonë rurale (NJA Levan) për ndërymishim e emërtimit të një rruge, kërkesë e ardhur nga një grup interesi dhe që u konsultua me të gjithë banorët e zonës ku mendohej të bëhej ky ndryshim. Ky ishte një rast i pastër i një vendimi të marrë në rrugë transparente pasi u miratua nga vet komuniteti.

- Gjatë kësaj periudhe duket që Këshilli I Bashkisë Fier ka rritur përgjegjësinë karshi vendimeve duke ndërmarrë nisma konsultuese disa herë me komisionet specifike të këshillit, përfaqësues kompetentë të ekzekutivit, trajnime për rritje kapacitetesh etj.
- Bashkia ndërkohë vijon ti publikojë njoftimet në rrugë institucionale në faqen zyrtare të bashkisë, fb e bashkisë, afishimin pranë zyrës me një ndalesë, afishimin pranë godinave të NJA-ve dhe në vende me akses të plotë nga qytetarët.
- Pavarësisht se situara pandemike gjatë kësaj periudhe ka qenë më e stabilizuar në pjesën më të madhe të takimeve të KBF-së kanë qenë online. Të pakta në numër kanë qenë dhe takimet e drejtëpërdrejta.
- Konsultimet e zhvilluara për buxhetin dhe paketën fiskale për vitin 2021 janë kryer me grupe interesi dhe me një numër të kufizuar pjesëmarrësisht. Këto konsultime u realizuan në bashkëpunim me qendrën Epoka e Re. Këto takime janë pasqyruar në rrjetet sociale edhe nga ana e Bashkisë Fier për të mbajtur të informuar publikun në kuadër të transparencës.
- Aktualisht në çdo njësi administrative, përfshirë dhe Bashkinë Qendër ka të vendosur kuti ankesash, në të cilën kushdo qytetar që ka një ankesë, por dhe kërkesë a sugjerim për çështje të ndryshme që prek komunitetin/qytetin/njësinë ka mundësinë dhe aksesin e plotë për ta hedhur atë në mënyrë anonime, ose dhe me emër konkret. Këto ankesa/sugjerime/mendime të qytetarëve, shqyrtohen në mënyrë periodike (nga 1 – 4 javë) nga një komision i përbërë nga zv/kryetarë bashkie dhe drejtorë, kryesisht të sektorëve të shërbimeve publike.
- Situata pandemike vijon të krijojë vështirësi në takime/grumbullime massive duke krijuar një hendek përsa i përket marrjes së mendimit në masë të gjerë. Takimet e zhvilluara për buxhetin, paketën fiskale, aktivitete të ndryshme kanë krijuar mundësinë e kontaktit të drejtëpërdrejtë me komunitetin edhe pse jo në masën e duhur.
- Pavarësisht përpjekjeve transparenca institucionale vijon të mbetet një prioritet që asnjëherë nuk duhet thënë plotësisht i adresuar. Ka ende shumë punë për tu bërë që të arrijmë në një pikë afër adresimit të plotë.
- Në faqen zyrtare të Bashkisë Fier gjatë kësaj periudhe kemi një ndryshim të madh në plotësimin e regjistrimit të transparencës, e cila një vit më parë nuk ekzistonte. Ky është një ndryshim pozitiv, por që kërkon ende përpjekje për pasurimin dhe ndryshimin e shumë elementëve të tjerë në këtë faqe.
- Njoftimet edhe pse realizohen në disa mënyra dhe në disa kanale transmetimi/publikimi përsëri në shumë raste nuk depërtojnë njësoj tek të gjithë qytetarët. Qytetarët shpesh herë nuk arrijnë të informohen në kohë, ndoshta dhe fare për këto organizime edhe pse kanë dëshirë/nevojë të marrin pjesë. Shumë të tjerë informohen shkarazi ose gabim duke shtuar edhe më tepër pasivitetin për t'u bërë pjesë e këtyre takimeve. Ende nuk ka një kanal gjithëpërfshirës informimi për të depërtuar njësoj, në kohë dhe hapësirë tek të gjithë qytetarët.

- Vijon të mbetet problematike pjesëmarrja cilësore e komunitetit/grupeve të interesit në konsultimet publike. Indiferenca e tyre dhe humbja e besimit ndaj institucioneve publike vijon të jetë një pengesë për këtë angazhim qytetar. **(pjesërisht i adresuar)**

Prioritet 2 : Infrastruktura

- Angazhimi i projektit POP edhe gjatë kësaj periudhe ka qenë maksimal përsa i përket infrastrukturës në shkolla dhe kryesisht në terrenet sportive, por mesa duket nevoja për rikonstrukcionin e më shumë shkollave për shkak të gjendjes së rënduar të tyre, shtimi disafish më shumë i shërbimit Dezinfektim/Dezinsektim në të gjithë territorin e bashkisë përfshirë godinat arsimore ka bërë që vëmendja të ketë qenë e fokusuar pikërisht në këto nevoja.
- Duhet të intensifikohet nxitja për përfshirjen e sa më shumë shkollave në rikonstrukcion dhe krijimin e terreneve sportive në pjesën më të madhe të tyre pasi ose nuk ekzistojnë, ose nuk kanë kushtet minimale për të funksionuar.
- Një tjetër problematikë është alokimi i fondeve të kufizuara për ndërhyrje. Duke qenë se nevojat janë disafish më të mëdha se buxheti në dispozicion edhe ndërhyrjet bëhen të pjeshme dhe në nevojat më immediate, por jo definitive. Kjo është arsyeja që shumë investime nuk janë të dukshme për vet faktin se bëhen të shkëputura në periudha të ndryshme atëherë kur gjendet mundësia e investimit.
- Përsa i përket terreneve sportive, këtë vit nga ana e Bashkisë Fier nuk është investuar në asnjë terren sportiv në shkolla apo jashtë tyre, por është investuar në veshjen me elementët e nevojshëm (ndricim, mobilim, shtrim tapeti bari etj) për terrenet sportive pranë ETC. Është fakt që këto terreni janë finalizuar dhe pritet të shërbejnë për të gjitha aktivitetet sportive të ngrupmoshave të ndryshme, qytetarëve, madje edhe për aktivitete të ndryshme kulturore edukative. Këto ambiente do të shërbejnë edhe në formën e një pallati sporti me akses të gjerë.
- Përveç ambienteve të brendshme, Bashkia Fier I ka kushtuar rëndësi edhe infrastrukturës së jashtme. Për një akses më të mirë është investuar në infrastrukturën rrugore dhe hapësirave të parkimit, për një aksesueshmëri sa më të plotë.
- Njëkohësisht për vitin tjetër pritet që të investohet në rikonstrukcionin e plotë të 3 (tre) shkollave dhe ndërtimin e 3 (tre) terreneve sportive, ndërtimin e një shkolle dhe çerdhe të re.
- Përsa i përket funksionimit të shkollave si qendra komunitare, nga monitorimi, informacionet e marra nga komuniteti dhe Bashkia Fier të gjitha investimet e bëra në të gjitha shkollat e Bashkisë Fier deri më sot kanë qenë me fokus të transformimit të tyre edhe si qendra komunitare në ato zona ku shihet e nevojshme bazuar në sipërfaqen territoriale dhe interesin që vet komuniteti shfaq. Problemi qëndron në mungesën e një stafi mbikqyrës gjatë funksionimit të tyre si qendra komunitare jo vetëm për ambientet,

por dhe asistimin me aktivitete të ndryshme sportive. Aktualisht janë vetëm pak shkolla që funksionojnë të tilla, duke shfrytëzuar vetëm ambientin nga komuniteti, kryesisht fëmijët dhe këto në qytet dhe në pak zona urbane si: Levan, Dërmënas, Libofshë, Cakran. Aktualisht në territorin e Bashkisë Fier funksionojnë 3 (tre) qendra komunitare: Levan, Baltëz dhe Fier qytet, në pjesën më të madhe të të cilave frekuentohen nga komuniteti rom/egiptian.

- Në disa zona ka qenë dhe vet komuniteti i prindërve që ka kërkuar mbylljen e portës së shkollës pas përfundimit të orarit mësimor si një mënyrë mbrojtëse e ambientit të shkollës nga personat e papërgjeshëm, deri në momentin që do të ketë staf mbikqyrës nga Ministria e Arsimit. Me mbylljen e shkollave dhe vijimin e procesit mësimor online, të gjitha shkollat kanë qenë të mbylluara.
- Si qendra komunitare janë përshtatur ambientet e jashtme të shkollave për ato zona ku mungon hapësira publike. Në zonat me hapësirë të mjaftueshme publike në qendër të tyre, është krijuar mundësia e një miniparku që shërben si qendër komunitare. Aktualisht kjo është një problematikë në zhvillim.
- Ringritja e qendrës komunitare të Semanit edhe pse nuk ka një rezultat konkret ka një praktikë që po merr rrugë. Komuniteti i Semanit, kryesisht gra dhe të rinj dhe me mbështetjen e qendrës Epoka e Re janë organizuar për të ndërmarrë një peticion drejtuar Bashkisë Fier, me anë të së cilës kërkojnë angazhimin e kësaj të fundit për ringritjen e kësaj qendre komunitare. Ata janë shprehur se godina tashmë është gati dhe ajo që duhet është vetëm një staf i vogël për aktivitetet dhe një buxhet jo shumë i konsiderueshëm për mobilimin minimal të saj.
- Bashkia Fier është shprehur se edhe për këtë nismë është e gatshme të jetë bashkëfinancuese, por e vetme nuk arrin ta mbulojë dot. Është në tratativa për të gjetur partner për ta realizuar atë. Është një çështje që do të vazhdojë të llobohet nga ana e projektit për të nxitur edhe më shumë Bashkinë Fier drejt gjetjes së mbështetjes financiare. **(pjesërisht e adresuar)**

Prioritet 3: Shërbimet sociale

Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë.

Kjo është një çështje e diskutuar masivisht me komunitetin, kryesisht me gratë dhe është një nevojë e mbështetur si e tillë edhe nga qeverisja vendore. Hapja e një qendre të tillë shihet si një domosdoshmëri për Bashkinë Fier si një ndër qytetit me popullsi të konsiderueshme dhe në rritje, por që mund të funksionojë edhe për bashkitë e tjera të qarkut. Bashkia Fier tashmë prej vitesh ka gati projektin për ngritjen e një qendre pritëse psiko – sociale jo vetëm për gratë e

dhunuara por dhe për fëmijët. Ky projekt është lobuar dhe vijon të lobohet vazhdimisht me Ministrinë, organizata të ndryshme edhe ndërkombëtare, por nuk ka mundur të gjejë mbështetje financiare. Mesa duket prioritetet e Bashkisë Fier dhe ato të Ministrisë apo organizamave ndërkombëtare nuk përputhen duke e lënë zbuluar këtë kërkesë të vazhdueshme. Bashkia Fier përvec projektit ka gati dhe alternativat për vendin e ngritjes së kësaj qendre. Ajo është prehur se është e gatshme të vërë në dispozicion godinën dhe stafin funksional për mbarëvajtjen e saj. Deri tani ende nuk ka një rezultat, por përpjekjet dhe angazhimi ynë për të nxitur finalizimin e ndërtimit të saj do të vazhdojë. **(E paadresuar)**

Prioritet 4: Vëmendje ndaj të rinjve

Buxhet specifik për të rinjtë dhe ngritja e një strukture (drejtorie) të veçantë në bashki që të koordinojë marrëdhënien dhe ndërveprimin me të rinjtë.

- Ajo që vihet re në progresin e këtij prioritet është fakti se tashmë në Bashkisë Fier ajnë bërë hapa të rëndësishëm në formalizimin e Komisionit Vendor Rinor. Edhe pse mungon një drejtori apo buxhet specifik për të rinjtë ngritja e një strukture rinore do të sjellë ndryshime thelbësore edhe në mënyrën e menaxhimit dhe administrimit institucional. Aktualisht koordinimi i të rinjve dhe aktiviteteve me dhe për të rinjtë bëhet nga Drejtoria e Artit dhe Kulturës me sektorin e QAK-së.
- Prezenca imponuese e të rinjve në takime, mbledhjet e Këshillit Bashkiak, konsultime publike si dhe funksionimi i Këshillit Rinor Vendor do të jetë një mundësi për ta çuar drejt zgjidhjes këtë pikë të kontratës sociale dhe do të ndikojë në rritjen e pjesmarrjes së të rinjve në vendimarrjen lokale. **(pjesërisht e adresuar)**

Prioritet 5: Vëmendje ndaj fëmijëve

- Kthimi në identitet i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, duke rikthyer gjithashtu edhe grupet dhe kurset jashtë-shkollorë të fëmijëve, të cilët ishin të papërfaqësuar ka qenë më shumë se një prioritet i kontratës. Ky ka qenë një shqetësim i vazhdueshëm për të gjithë komunitetin kryesisht ato familje që kishin fëmijë të grupmoshës 6 – 18 vjeç. .
- Deri një vit më parë kjo qendër kishte një apati dhe mungesë të larmishmërisë së aktiviteteve dhe kurseve/rretheve zhvilluese. Qëllimi i ngritjes së kësaj qendre që dikur ka qenë Shtëpia e Pionierit, më pas Qendra Kulturore e Fëmijëve angazhonte vetëm fëmijë të moshës 6-14 vjeç. Sot me ndryshimin edhe të emërimit (Qendra e Aktiviteteve Kulturore) ndryshoi dhe fokusi i kësaj qendre. Ajo përfshiu në organizim edhe të rinjtë deri në moshën 18 vjeç duke përmbushur kështu një nga pikat e prioritetit për ata që ishin të papërfaqësuar.

- Gjatë kësaj periudhe shtator 2020 – shtator 2021, kjo qendër ka hapur kurset e munguara dhe rrethet artistike të cilat kanë bërë që ajo të funksionojë tashmë me kapacitet thuajse të plotë. Janë hapur kurset dhe rrethet për këngë, muzikë, pikturë, kërcim, shah, sporte, letrarëve, aktrim, etj). [\(I adresuar\)](#)

Rekomandime

Prioritetet e Kontratës Sociale për Bashkinë Fier janë prioritete të nxjerra nga vet komuniteti bazuar në orientimin e të rinjve, të cilët kanë qenë promotorë të hartimit të saj. Ato janë prioritete të arsyeshme dhe me bazë ligjore të kapërcyeshme me mundësi reale përmbushjeje.

Gjatë këtij monitorimi në periudhën shtator 2020 – shtator 2021 u vu re një angazhim i bashkisë për të siguruar një emërues të përbashkët mes prioriteteve institucionale dhe asaj të dakordësuar dhe zyrtarizuar me kontratën sociale 2019 me Epokën e Re.

Pavarësisht vullnetit dhe angazhimit mbetet ende shumë për të bërë deri në përmbushjen e plotë të prioriteteve të dala nga qytetarët e Fierit. Qendra Epoka e Re do të vijojë monitorimin e punës së bashkisë, drejtorive përkatëse dhe vendimarrjen e Këshillit të Bashkisë.

Në vijimësi të punës, tipologjisë, angazhimit dhe mundësive që ka sot Bashkia Fier, listojmë si vijon më poshtë rekomandimet kryesore:

- Gjetja e mënyrave të reja dhe fleksible për nxitjen e angazhimit të komunitetit për të siguruar përfshirje cilësore, stabilitet në vendimarrje dhe rezultat.
- Kthimi i besimit të qytetarëve nevojë emergjente për rezultate konkrete të bashkëpunimit komunitet – qeverisje vendore.
- Prezantimi i prioriteteve të komunitetit (problematikave) të shprehura gjatë konsultimeve publike për projekt-buxhetin dhe paketën fiskale që Bashkia Fier ka përfshirë në buxhet me argumentimin e nevojshëm është shumë e rëndësishme edhe për të nxitur rritjen e besimit qytetar.
- Zbatimi i ligjit për konsultimin publik, njoftimet publike, dhe ndjekjen e procedurave (rregullores) për dëgjuesat publike.
- Puna e Epokës së Re të fokusohet edhe në nxitjen e sa më shumë kontakteve,

konsultimeve, takimeve të bashkisë me komunitetin.

- Informim në kohë dhe i detajuar mbi detyrimin e taksave dhe tarifave vendore, pasi qytetarët ende nuk dinë me saktësi nivelin e pagesës së tarifave për shërbim, apo taksave të tjera vendore.
- Gjetja e një mënyre/formati më të thjeshtë e i kuptueshëm nga çdo qytetar, pavarësisht nivelit të arsimimit të tij, lidhur me të ardhurat e mbledhura, menaxhimin e tyre dhe ku shkojnë taksat e tyre.
- Të vijojë prezenca e të rinjve në çdo mbledhje të Këshillit Bashkiak, dëgjesa publike apo takime formale, pasi është një “presion” pozitiv që forcon pozitën e të rinjve në qeverisje vendore, gjithashtu dhe ndikimin.
- Rritja e ndërveprimit bashki – rini në nivel vendor, vullnet i shtuar për orientim/ofrim të shërbimeve dhe programe sa më cilësore për të rinjtë.
- Të rritet angazhimi për krijimin e kushteve më të mira në shkolla, kopshte, çerdhe dhe konvikte, duke nxitur krijimin e një standardi e jo vetëm plotësimin e kushteve minimale.
- Rritja e investimeve në krijimin e terreneve të reja sportive dhe riparimin e atyre ekzistuese në shkolla dhe hapësira publike, kryesisht në zonat rurale.
- Rritja e angazhimit dhe hapja e fushave të reja të kërkimit për mbështetje financiare për ndërtimin e qendrës psiko sociale.
- Vënia në funksion e shkollave edhe si qendra komunitare.
- Hapjen e qendrave të reja komunitare jashtë fokusit të nxitjes së projekteve (rom, egjiptian), por të nevojshme dhe me kërkesë të komunitetit (qendra komunitare Seman).
- Rritja e “presionit” nëpërmjet ngarkesës ligjore për krijimin e një portofoli të nevojshëm në buxhetin e bashkisë për angazhimin dhe aktivitetet rinore dhe për të rinjtë.
- Të shikohen me përparësi prioritetet e papërmbushura, si edhe shqetësimet e ngritura nga grupet e interesit/komuniteti gjatë takimeve të realizuara gjatë periudhës shtator 2020 – shtator 2021.
- Nxitje për rritjen e numrit të aktiviteteve, cilësinë e tyre, përfshirjen me qëllim sigurimin e rezultateve konkrete për garantimin e plotë të kthimit në identitet të QAK-së.

Anekse

Aneks 1 Mbledhjet e Këshillit Bashkiak

Nr.	Nr. vendim	Subjekti I vendimit	Data	Mënyra
1.	60	Ndihma ekonomike nga fondi I kushtëzuar 6% për muajin gusht 2020.	25.09.2020	Në sallën e mbledhjeve. Fizikisht
2.	61	Pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier.		
3.	62	Mbulim i vlerës financiare të shpronësimit në interes publik, për pronat që preken nga zbatimi I projektit “rehabilitimi i rrugës Xoxi Andoni”.		
4.	63	Një ndryshim dhe shtesë në venimin Nr. 10 dt. 20.10.2016, për shpronësime në interes publik, për pronat që preken nga zbatimi I projekteve prioritare “Rikonstruksioni I rrugës Jakov Mile segmenti 1) dhe rikonstruksioni I rrugës Mujo Ulqinaku (segmenti 2.		
5.	64	Shpronësim në interes publik për pronat që preken nga zbatimi i projektit për rehabilitimin e lumit Gjanicë faza II.		
6.	65	Rishpërndarje e fondeve në buxhetin e bashkisë Fier për vitin 2020.		
7.	66	Ndihmë financiare për një familje në NJA Libofshë, për dëmtimin e banesës nga zjarri.		
8.	67	Shpronësim në interes publik për pronat që preken pjesërisht nga realizimi I projektit për ndërtimin e rrjetit KUZ në Mbrostar.		
9.	68	Dhënie me qira e pronës së bashkisë për një veprimtari mësimdhënieje dhe aktivitete argëtuese e kreative.		
10	69	Shtimine listës së familjeve të pastreha për t’u trajtuar nga programet sociale të strehimit: “subvecionim I interesave të kredisë” dhe “subvecionim I qirasë në tregun e lirë”.		

11	71	Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin shtator 2020.	27.10.2020	Në sallën e mbledhjeve. Fizikisht
12	72	Shpronësim në interes publik për pronat që preken nga zbatimi I projektit “rivitalizimi I rrugës Andon Profka dhe I hapësirave përreth.	2.11.2020	Online Platform Zoom
13	74	Pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier.		
14	75	Ndihmë financiare për një familje që i është dëmtuar banesa nga zjarri . (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
15	76	Ndihmë financiare për një familje që i është dëmtuar banesa nga tërmeti i datës 21.09.2019. (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
16	77	Ndihmë financiare për një familje që i është dëmtuar banesa nga tërmeti i datës 21.09.2019. (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
17	78	Ndihmë financiare për një familje që i është dëmtuar banesa nga tërmeti i datës 21.09.2019. (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
18	79	Ndihmë financiare për një familje që i është dëmtuar banesa nga tërmeti i datës 21.09.2019. (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
19	80	Ndihmë financiare për një familje që i është dëmtuar banesa nga tërmeti i datës 21.09.2019. (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
20	81	Ndihmë financiare për një familje në NJA Cakran që i është dëmtuar banesa nga zjarri . (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
21	84	Nisje procedurash për marrjen me qira të ambienteve për kopshte për Bashkinë Fier.		
22	87	Miratime familjeve të pastreha që përfitojnë nga programi social i subveconimit të qirasë në tregun e lirë dhe të masës së subveconimit të kësaj qiraje.		
23	89	Miratimi i familjeve që përfshihen në trajtimin me ndihmë ekonomike në formës e riparimit të shtëpive.		
24	90	Miratimi i rregullores për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin strukturave komunitare në bashki.		
25	93	Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin tetor 2020.		

26	95	Miratimi inivelit të taksave dhe tarifave vendore 2021.	2.12.2020	Online Platform Zoom
27	97	Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin nëntor 2020.		
28	98	Pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier.	17.12.2020	Online Platform Zoom
29	99	Miratimi I buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2021.		
30	100	Miratimi I tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të buxhetit afat mesëm (PBA) 2021 – 2023 të Bashkisë Fier.		
31	101	Ndihmë financiare për një familje që i është dëmtuar banesa nga zjarri i datës 4.11.2020. (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
32	102	Ndihmë financiare për një familje që i është dëmtuar banesa nga zjarri i datës 4.11.2020. (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
33	103	Ndihmë financiare për një familje nga NJA Frakull që i është dëmtuar banesa nga zjarri i datës 15.09.2020. (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
34	104	Ndihmë financiare për një familje nga NJA Levan që i është dëmtuar banesa nga zjarri i datës 14.01.2020. (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
35	109	Nisje procedurash për blerjen e pasurisë godinë + truall për krijimin e ambienteve të reja për kopsht dhe qendër shëndetësore në fshatin Portëz NJA Portëz.	28.12.2020	Online Platform Zoom
36	110	Për autorizim I Bashkisë Fier për ndarjen e pakove ushqimore me rastin e festive të fundvitit 2020.		
37	111	Miratim I trajtimit me bonus qiraje të familjeve që nuk disponojnë dokumenta pronësie të banesave që preken nga projektet infratrakturore të bashkisë.		

38	1	Miratimi I dokumentave të rishikimit të planit të përgjithshëm vendor të BF, miratuar me vendim të KKT.	18.01.2021	Online Platform Zoom
39	2	Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin dhjetor 2020.	1.02.2021	Online Platform Zoom
40	3	Miratimi I kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e Bllok – Ndihmës ekonomike deri në 6% dhe/ose me fondet e buxhetit vendor.		
41	4	Ndihmë financiare për një familje që i është dëmtuar banesa nga zjarri i datës 09.11.2020. (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
42	5	Për bursat e nxënësve që ndjekin programet mësimore pranë shkollave profesionale.		
43	6	Pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier.		
44	9	Ndihmë ekonomike për një kurimin e një vajze.		
45	10	Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin janar 2021.		
46	11	Miratimi I listës emërore të familjeve të pastreha që kanë aplikuar për një nga programet e strehimit dhe I listës së familjeve të reja të pastreha.	2.03.2021	Online Platform Zoom
47	12	Miratimi ivlerës mesatare të qirasë në tregun e lirë, për efekt të llogaritjes së masës së subvecionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi.		
48	13	Miratimmi ndryshimit të nivelit të përfaqësimit të nxënësve dhe studentëve në olimpiadat kombëtare dhe ndërkombëtare, maturën shtetërore, cmime dhe përcaktimi I masës së shpërblimit.		

49	16	Miratimi I raportit të monitorimit të buxhetit të Bashksië Fier për vitin 2020.		
50	18	Miratimi I ndihmës ekonomike për familjet në nevojë.		
51	19	Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin shkurt 2021.	16.03.2021	Online Platform Zoom
52	20	Dërgim I fondit të rritjes së pagave për funksionin e arsimit parashkollor.		
53	24	Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin mars 2021.	16.04.2021	Online Platform Zoom
54	25	Ngritja e komisionit të strehimit në zbatim të programeve sociale të strehimit.		
55	26	Ndihmë financiare për një familje që i është dëmtuar banesa nga zjarri i datës 06.02.2021. (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
56	27	Ndihmë financiare për një familje që i është dëmtuar banesa nga zjarri i datës 25.01.2021. (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
57	29	Pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier.		
58	30	Miratim i ndihmës ekonomike për familjet në nevojë.		
59	32	Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin prill 2021.	26.05.2021	Online Platform Zoom

60	33	Pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier.		
61	37	Miratimin e vazhdimet të kryesrjes së pastrimit dhe largimit të mbeturinave në NJA dhe kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike në NJA me sipërmarrje.		
62	38	Miratim ndihme ekonomike për familjet në nevojë.		
63	41	Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin maj 2021.	29.06.2021	Online Platform Zoom
64	42	Pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier.		
65	48	Ndihmë financiare për një familje që i është dëmtuar banesa nga zjarri i datës 8.02.2021. (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
66	49	Miratim ndihme ekonomike për rast sëmundjeje.		
67	50	Miratimin e vazhdimet të kryesrjes së pastrimit dhe largimit të mbeturinave në NJA dhe kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike në NJA me punonjës të Bashkisë Fier.	23.07.2021	Online Platforma Zoom
68	51	Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin qershor 2021.		
69	52	Miratimin e familjeve të pastreha për tu strehuar si qiramarrës në banesat sociale.		
70	54	Dhënie e banesës pa pagesë për një periudhë 6 mujore për një viktimë dhune në familje.		

71	55	Ndihmë financiare për një familje në fshatin Grykë NJA Topojë, që i është dëmtuar banesa nga zjarri i datës 25.05.2021. (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
72	56	Pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier.		
73	57	Miratim fondi për aktivitetin "Turi I 78-të ciklistik.	6.08.2021	Online Platform Zoom
74	62	Për caktimin e procedurës së negociimit për zhvilluesin privat që shpreh interes që të bashkëpunojë me BF ndërmjet marrëveshjes së sipërmarrjes/shkëmbim për pronën në pronësi të saj.		
75	66	Pranim në shtëpinë e të moshuarve Fier.	27.08.2021	Online Platform Zoom
76	69	Miratim ndihme ekonomike për 3 (tre) fëmijë jetim, një prej tyre e vajzës së gruas që u vra nga bashkëshorti I saj.	14.09.2021	Në sallën e mbledhjeve
77	72	Miratim ndihme ekonomike për kurimin e një djali.		
78	73	Ndihmë financiare për një familje në fshatin Vreshtaz NJA Cakran, që i është dëmtuar banesa nga zjarri i datës 28.06.2021. (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
79	74	Ndihmë financiare për një familje, që i është dëmtuar banesa nga zjarri i datës 07.08.2021. (Nga fondi i Mbrojtjes civile).		
80	75	Miratimi i ndryshimeve në vlerën e subveconit të qirasë dhe skualifikimin e familjeve të pastreha përfituese nga program i subveconimit të qirasë në tregun e lirë miratuar me VKB Nr.11 dt. 02.03.2021.		

Aneks 2 - Referenca

- Faqja zyrtare e Bashkisë Fier <http://bashkiafier.gov.al/sq-al/Pages/default.aspx>
- FB Bashkia Fier <https://ëëë.facebook.com/bashkia.efierit/>
- <http://bashkiafier.gov.al/sq-al/Bashkia/Pages/Njoftime.aspx>
- <http://bashkiafier.gov.al/sq-al/Services/Pages/Kerkese-Ankese.aspx>
- <http://bashkiafier.gov.al/sq-al/Services/Pages/Programi-i-transparences-.aspx>
- <http://bashkiafier.gov.al/sq-al/Services/Pages/E-drejta-p%C3%ABr-informimit.aspx>
- <http://bashkiafier.gov.al/sq-al/Services/Pages/Regjistri-K%C3%ABrkes%C3%AB-P%C3%ABrgjigje.aspx>
- Faqja e Këshillit të Bashkisë Fier <http://bashkiafier.gov.al/sq-al/Keshilli/Pages/default.aspx>
- FB e Këshillit të Bashkisë Fier <https://ëëë.facebook.com/pages/category/Not-a-Business/K%C3%ABshilli-Bashkiak-Fier-104337948185698/>
- Kontrata Sociale <https://popnetëork.al/raporti-nje-vjecar-kontrata-sociale-bashkia-fier/>
- Kontrata Sociale Fier viti I parë I monitorimit <https://popnetëork.al/kontrata-sociale-fier-permbushja-e-prioriteteve-viti-i-pare-i-monitorimit/>
- Raporti studimor mbi pjesëmarrjen dhe angazhimin qytetar në nivel vendor <https://popnetëork.al/raporti-studimor-pjesemarrja-dhe-angazhimi-qytetar-ne-nivel-vendor-fier/>
- Vendimet e KB Fier <https://popnetëork.al/shkurt-21-vendimet-e-keshillit-bashkiak-fier/>
- Prezantimi I Kontratës Sociale <https://popnetëork.al/prezantimi-i-raportit-nje-vjecar-kontrata-sociale-pop-bashkia-fier/>
- Takime me komunitetin <https://popnetëork.al/takime-me-komunitetin-e-bashkise-fier/>
- Forumi publik <https://popnetëork.al/forumi-publik-pop-2019-fier/>
- Raporti mbi Covid-19, Bashkia Fier [Raporti Bashkia Fier COVID-19](#)

Aneksi 3 - Kontrata Sociale

